KUVENDI
NR 1361 DATE 31.03.26

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
GUVERNATORI

Nr. 2526 Prot.

Tiranë, më 30.3.2026

Lënda: Raporti Vjetor i Bankës së Shqipërisë për vitin 2025

SH.T.Z. Niko PELESHI
KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë Raportin Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2025, të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës në mbledhjen e datës 4 mars 2026. Raporti analizon ecurinë e ekonomisë shqiptare gjatë vitit të kaluar dhe performancën e institucionit në përmbushjen e detyrave ligjore.

Në funksion të llogaridhënies publike, Raporti ofron një vlerësim të detajuar për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë, duke listuar aktet e miratuara dhe masat e marra nga ana jonë (Shtojca nr. 1, bashkëlidhur Raportit).

Përmbajtja e Raportit përfshin të gjitha çështjet – me natyrë të përgjithshme dhe të posaçme – e identifikuara në Manualin e Monitorimit Vjetor dhe Periodik të Kuvendit. Një informacion mbi përputhshmërinë me rregullat e Manualit gjendet në Shtojcën nr. 2, bashkëlidhur Raportit.

Në funksion të transparencës, pjesë përbërëse e Raportit janë edhe pasqyrat financiare të Bankës së Shqipërisë, të kontrolluara nga auditori i jashtëm (*Ernst & Young*), si dhe të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës më 25 mars 2026. Siç certifikohet nga auditori i jashtëm, pasqyrat financiare ofrojnë një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar dhe të rezultateve të operacioneve tona për vitin 2025.

Së fundmi, në traditën e raportimeve tona për Kuvendin, Raportit i bashkëlidhet një informacion për aktivitetin dhe rezultatet vjetore të Auditimit të Brendshëm. Ky informacion synon të ofrojë një siguri të pavarur e të arsyeshme mbi cilësinë dhe efektivitetin e kontrolleve të brendshme në Bankën e Shqipërisë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Me respekt,

GUVERNATOR

Gent SEJKO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË